

ZHVILLIMET DEMOGRAFIKE DHE PROBLEMATIKA SHOQËRUESE NË HAPËSIRËN SOCIOGJEOGRAFIKE TË LAPRAKËS

Brunilda OSMOVI-BIBE¹

ABSTRAKT

Zhvillimet e popullsisë janë të ndërlidhur me zhvillimet ekonomike e sociale. Analizat e popullsisë synojnë t'u përgjigjen nevojave konkrete, aktuale e prespektive të zhvillimit në cdo zonë. Migracioni i brendshëm solli mbipopullim të disa rajoneve të vendit, çka për pasojë u shoqërua me ndryshime të mëdha sociale, ekonomike e mjedisore të këtyre zonave. Nga ana tjetër, vetë ndryshimet politike, sociale dhe ekonomike në vend, gjatë tranzicionit, sollën ndryshimin dhe shpeshherë përshpejtimin e fenomeneve demografike. Fluksi masiv i imigrimit drejt qyteteve kryesore e ka tejkaluar kapacitetin mbajtes të tyre në lidhje me strehimin, infrastrukturën bazë, si dhe në kuptimin e veprimtarive që krijojnë vende pune e sjellin të ardhura. Lëvizja migratore e popullsisë ka rezultuar shumë e çorganizuar dhe e pakontrolluar. Rezultat i mungesës së kontrollit ka qenë përhapja abuzive e ndërtimeve të karakterizuara nga konstruksione të reja në më të shumtën e rasteve në brendësi e periferi të qyteteve, duke rritur sipërfaqen e tyre, e cila natyrisht nuk është pajisur me ndonjë lloj shërbimi urbanistik ose ndërlidhjeje. Këtu mund të përmendet zgjerimi i qytetit të Tiranës në zonat periferike si: Bathore, Kamëz, Laprakë, Kombinat, Yzberish etj.

Fjale kyce : migrim i brendshëm, strukturë moshore, ndikime negative, zhvillim i qëndrueshëm, shtim i mundësive, papunësia .

HYRJJE

Ky punim ka si qëllim evidentimin e problematikës social- ekonomike të Njësisë Bashkiake 11. Si rezultat i lëvizjes së lirë të popullsisë pas viteve 1990, rreth 75% e popullsisë në këtë njësi përbëhet nga të ardhurit. Për realizimin e këtij punimi u kryen një numër i konsiderueshëm anketimesh me banorët e njësisë, nga të cilët u përfitua informacion i rëndësishëm, përsa i përket të dhënave demografike, të dhënave ekonomike, cilësisë së jetës,

¹ **Msc.Brunilda OSMOVI-BIBE** : E-mail brunaosmovi@yahoo.com
Shkolla e Mesme “Arben Broci” Tirana- Albania

situatës së banimit, etj, të cilat janë ndërthurur me të dhëna të mbledhura nga institucione të ndryshme, duke u integruar në cështje të caktuara.


1.LOKALIZIMI I HAPËSIRËS SOCIOGJEOGRAFIKE TË LAPRAKËS

Me organizimin e ri administrativ të qytetit në 11 njësi bashkiake u krijua dhe Njësia 11 me qendër në Laprakë që shtrihet në veriperëndim të Tiranës. Ka një sipërfaqe prej 5.98 km² dhe largësia mesatare nga qendra e Tiranës është 4 km. Njësia Bashkiake 11 është e përbërë nga tri zona të njohura me emërtimet: Lapraka, Bregu Lumit, dhe Kodër-Kamza. Migracioni mund të cilësohet si një fenomen që historikisht ka ndikuar ndryshimet e popullsisë që nga shpallja e Tiranës si kryeqytet i Shqipërisë. Pas viteve 1990-të, fenomeni i migrimit u shfaq kaotik dhe i pakontrolluar, duke sjellë në qytet probleme sociale të reja, veç atyre të trashëguara nga e kaluara. Problemet e reja sociale dhe ekonomike si dhe ato të infrastrukturës e kanë bërë edhe më të vështirë përmirësimin e gjendjes së përgjithshme të shërbimeve publike në qytet e veçanërisht për zonat informale. Në popullimin e Njesisë Bashkiake 11 sidomos pas vitit 1990 kane ndikuar: pozita e përshtatshme rajonale, ekzistenca e sipërfaqeve të lira toke, ekzistenca e ndërtesave boshe si ato të Universitetit Bujqësor dhe Shkollës së Partisë, qeratë e ulta, etj.

2.DINAMIKA E POPULLSISË DHE PROBLEMATIKA SHOQËRUESE

Në Njësinë Bashkiake 11 numri i popullsisë ka ardhur duke u rritur nga viti në vit e ndikuar si nga shtimi natyror ashtu edhe nga lëvizja migratore. (shih, grafikun nr 1). Njësia Bashkiake 11 dallohet për koeficientë të lartë lindshmërie dhe kjo është e lidhur me moshën e re mesatare të kësaj njësie, si dhe me mentalitetin e të ardhurve të vendosur në këtë njësi. Nga regjistrimi i popullsisë (INSTAT, 2001), nivelin më të lartë të indeksit sintetik të lindshmërisë e arrin Rajonin Verior i vendit me 3,26 fëmijë për një grua në moshë lindjesh, dhe janë pikërisht të ardhurit nga ky rajon që dominojnë në Njësinë 11¹. Saldoja migruese, ka luajtur rolin kryesor në ndryshimin e numrit të popullsisë deri në vitin 1997. Ky tregues, në vitet 1996-1999, ka përbërë 92,9% të shtesës së përgjithshme të popullsisë². I njëjti konkluzion rezulton dhe për periudhën 1997-2002, ku për Tiranën saldoja migruese ka përbërë 85,6% të shtesës së përgjithshme të popullsisë, për Njësinë 11 ky tregues ka përbërë 78,8% të shtesës së përgjithshme të popullsisë. Ndërsa për periudhën 2003-2008 për Njësinë 11 ndikimi i saldos

migruese në ndryshimin e numrit të popullsisë fillon të pakësohet. Për këtë periudhë, saldoja migruese përbën vetëm 43% të shtesës së përgjithshme të popullsisë. Roli i saldosit migruese pakësohet nga viti në vit për të mbërritur në vitin 2010, ku peshën kryesore në shtimin e numrit të përgjithshëm të popullsisë e ka shtimi natyror.



Grafiku 1: Ecuria e numrit të popullsisë për periudhën 1991-2010

Burimi: Zyra e Statistikës, Bashkia Tiranë

Në pakësimin e numrit të të ardhurve mund të kenë ndikuar një sërë faktoresh si për shembull, vështirësitë për të siguruar një sipërfaqe të lirë ndërtimi për shkak të pakësimit të tokës së lirë bujqësore, rritja e vazhdueshme e kostos së ardhjes dhe vendosjes së popullsisë, zhgënjimet e shumë familjeve, vështirësi në përshtatjen me kushtet e tregut të punës në rajonin e kryeqytetit, mungesa e besimit për të ardhmen, pasi shumica e të anketuarve kryesisht moshat e reja e shohin të ardhmen jashtë vendit. Kjo lëvizje migratore ka ndikuar edhe në strukturën moshore të popullsisë, Njësia Bashkiake 11 është njësia që ka moshën mesatare më të re të popullsisë, koeficienti i moshimit të popullsisë është më i ulët i krahasuar me njësitë e tjera (INSTAT, 2001), ndërsa përta e përket strukturës së familjes sipas anëtarëve kemi një bashkjetesë të familjes bërthamë me familjen e madhe.

2.1. Papunësia.

Njësia Bashkiake 11 dallohet për nivelin e lartë të papunësisë, për përqindjen e lartë të personave me punë sezonale apo të rastit dhe pikërisht për këtë arsye numri i familjeve që mbështeten me ndihmë ekonomike nga shteti është i lartë. Nga krahasimi i të dhënave të vitit 2001 me ato të periudhës 2002- 2010 (shih tabelen nr 1), kemi një zvogëlim të përpjesës të punësuarve me punë të përhershme dhe rritje të përpjesës të punësuarve me punë të përkohëshme Gjithashtu, kemi rritje të përpjesës të punësuarve në punë sezonale dhe në punë të rastit, pra më shumë familje që nuk varen nga

të ardhurat mujore fikse. Ky fakt dëshmon qartë situatën e vështirë ekonomike të Njesisë 11 dhe përkeqësimin e saj.


Tabela 1. Përpjesa e të punësuarve sipas llojit të punësimit në Njësinë Bashkiake 11 në periudhën 2002-2010 dhe në vitin 2001

| Njësia 11 | Përpjesa e të punësuarve me punë të përhershme | Përpjesa e të punësuarve me punë të përkohshme | Përpjesa e të punësuarve me punë sezonale | Përpjesa e të punësuarve me punë të rastit |
|-----------|--|--|---|--|
| 2002-2010 | 40% | 26% | 23% | 11% |
| 2001 | 67,7 | 18,5 | 8,1 | 5,7 |

Burimi: INSTAT 2001 dhe Anketimet

2.2. Arsimimi.

Njësia 11 ka numrin më të vogël të personave me shkollë të lartë, dhe me studime pasuniversitare, përqindjen më të lartë e përbëjnë personat me shkollim nëntëvjeçar (shih, grafikun nr 2.). Dallohet për numrin e lartë të analfabetëve pasi mbi 85% e nxënësve së Njesisë Bashkiake 11 janë të ardhur nga zonat verilindore, pas vitit 1990. Familjet e tyre mbartin probleme të thella sociale - ekonomike. Disa nga arsyet e mosfrekuentimit të shkollës gjatë anketimit ishin; arsyet ekonomike, mentaliteti, arsyet familjare, etj. Lëvizja e madhe e popullsisë, krijimi i zonave të reja urbane, shtimi i numrit të popullsisë, imigrimi, kanë bërë të mundur shtimin çdo vit të numrit të nxënësve, gjë që shtron domosdoshmërinë e përmirësimit e kompletimit të infrastrukturës arsimore për të gjithë nivelet.



Grafiku 2. Popullsia 25vjeç e lart sipas nivelit arsimor në Njësinë 11


Burimi: Anketimet

2.2.3. Problematika social-mjedisore

Rritja e numrit të popullsisë është shoqëruar me një rritje të ndjeshme të problematikës social-mjedisore ku përmendim, rritjen tepër të shpejtë të

numrit të ndërtimeve. Pas vitit 1990, kemi një bum ndërtimesh të cilat me mënyrën e stilit të tyre shumë të ndryshëm të ndërtimit i japin kësaj njësie pamjen e një nga zonave me tipike suburbane të Tiranës, duke sjellë krijimin e lagjeve periferike pa plane urbanistike. Është intensifikuar veprimtaria e njeriut në shfrytëzimin e resurseve natyrore. Aty ku diku shtriheshin sipërfaqe të tëra me drurë frutorë, sot syri të sheh vetëm ndërtime pa fund nga shtëpitë njëkatëshe deri tek pallatet 10-12 katësh (shih, grafikun nr 3). Kjo situatë nuk u shoqërua në mënyrë paralele me zhvillimin e infrastrukturës duke shënuar mungesa të theksuara të shërbimeve si; furnizimi me ujë, ndërtimi i rrugëve, shërbimet e ujit dhe të pastrimit të ujit, qendrave të reja për kujdesin shëndetësor, arsimor, mungesa e theksuar gati e plotë e gjelbërimit dhe e ambienteve çlodhëse për banorët. Shqetësim i madh për banorët e Njësisë është edhe Lumi i Tiranës që përshkruan njësinë dhe që karakterizohet nga dëmtime të shtratit dhe derdhje në të të ujërave të zeza. Në Njësinë 11 kemi familje që banojnë gjatë Bregut të Lumit të Tiranës. Dhjetra banesa të këtyre familjeve në këtë zonë përmblyen sa here bien reshje të dendura të shiut. Lapraka si pjesë e qytetit me mangësitë zhvillimore, përfaqëson problematikën suburbane të zhvillimit të fundit urban në Shqipëri. Njësitë 11 ka rreth 62 mijë banorë, rreth 16 biznese prodhues në industrinë e konfeksioneve, prodhimin të këpucëve, mobiljeve, përpunimit të drurit, materialeve të ndërtimit, rreth 600 njësi tregtare, 6 shkolla, 4 cerdhe dhe 4 kopshte për fëmijë, 3 qendra shëndetësore, por ka dhe shumë papunësi, ku 60% të fuqisë punëtore të aftë për punë janë të papunë. Të vetmet modele që afrojnë Laprakën me Tiranën, sot janë blloku i banesave “Gintash”, që sjell një mjedis të rregulluar dhe të sistemuar. Më tej pamjet ndryshojnë. Dhe me një popullsi ku mbi 75% janë të ardhur nga zonat rurale, Lapraka s’ka si të mos ketë dhe problemet e veta të rënda. Në vitet e fundit situata po ndryshon dhe fatmirësisht për më mirë, këtë fakt e vërtetojnë projektet e shumta si shtrimi i rrjetit të kanalizimeve, të linjave elektrike në zonën e Bregut të Lumit, kanalizimet të ujërave të bardha dhe të zeza në Kodër Kamëz dhe në zonën e Bregut të Lumit, rikonstruksioni i të gjitha segmenteve kryesore rrugore në zonën e Laprakës, etj. Menaxhimi urban është një proces zhvillimi ç’ka do të thotë se në rradhë të parë kërkohet një vizion në veprimet e zhvillimit. Vizion do të thotë të kërkohen dhe të kuptohen potenciale zhvillimi më afatgjata për zonën urbane. Kjo mund të arrihet përmes shqyrtimit të problematikës në niveleve të ndryshme.

Nr.1, Viti 2013



Grafiku 3. Përpjesa e banesave sipas viteve të ndërtimit, 2010
Burimi: Anketimet

PËRFUNDIME

Në Njësinë Bashkiake 11 numri i popullsisë ka ardhur duke u rritur nga viti në vit e ndikuar si nga shtimi natyror ashtu edhe nga lëvizja migratore. Njësia 11 ka numrin më të vogël të personave me shkollë të lartë, dhe me studime pasuniversitare, përqindjen më të lartë e zënë personat me shkollim nëntëvjeçar.

Njësia Bashkiake 11 dallohet për nivelin e lartë të papunësisë, për përqindjen e lartë të personave me punë sezonale apo të rastit dhe për numrin e madh të familjeve që mbështeten me ndihmë ekonomike nga shteti.

Rritja e numrit të popullsisë është shoqëruar me një rritje të problematikës social-ekonomiko-mjedisore.

REFERENCAT

1. Anketimet
2. Bashkia e Tiranës, *Formularë të Zyrës së Gjendjes Civile*
3. Bashkia e Tiranës, *Formulare të Sektorit të Statistikës*
4. Bashkia e Tiranës, *Buletini Statistikor 2005, 2006, 2008, 2009, 2010*
5. Bashkia e Tiranës dhe UNICEF " Vlerësimi i nevojave", 2003
6. Bashkia e Tiranës dhe Drejtoria e Kujdesit Social, "Projekt për braktisjen e shkollës dhe analfabetizmi
7. Karaguni. M , Dumani B , "Tirana Reliev Demo- Ekonomik e Social" 2005 ,
¹ faqe 1 shih, Karaguni. M , Dumani B , "Tirana Reliev Demo- Ekonomik e Social" 2005, fq 51.
² faqe 1 shih ,Karaguni. M , Dumani B , "Tirana Reliev Demo- Ekonomik e Social" 2005, fq 52
8. Njësia Bashkiake Nr.11 Zyra e Urbanistikës, Zyra e Gjendjes Civile, materiale të ndryshme